

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUTIN E SHËNDETIT PUBLIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Institutin e Shëndetit Publik me objekt: “Mbi zbatimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën 01.10.2012-31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, nr. 72, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 275/9, datë 30.06.2014, dërguar Drejtorit të Institutit të Shëndetit Publik z. Arjan BREGU, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave sa më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Nisur nga fakti se, punonjësit e Institutit të Shëndetit Publik, që në bazë të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, Kreu IV “Organizimi dhe funksionimi i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP)”, i ndryshuar, neni 12 “Organizimi i ISHP-së”, pika 2 ku citohet: *“ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni”*, bëjnë punë kërkimore shkencore, janë paguar dhe vazhdojnë të paguhen në bazë të vendimit të KM nr. 1231, datë 02.07.2008 *“Për pagat e punonjësve mbështetës, në institucionet buxhetore, dhe të nëpunësve, në disa institucione buxhetore”* i shfuqizuar me VKM nr. 717, datë 23.06.2009 *“Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”*, i ndryshuar dhe për pasojë, pagat e tyre nuk rregullohen me dispozita ligjore, **është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik të përgatisë në mënyrë urgjente draft propozimin për të rregulluar këtë problematikë dhe ta paraqesë pranë Ministrinë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave, duke e shoqëruar me domosdoshmërinë e rregullimit të kuadrit ligjor për pagat e punonjësve të profilit kërkimor shkencor edhe për faktin që, kjo mungesë shkakton paralizim të pagesave deri në plotësimin e dispozitës munguese. Gjykojmë se është e domosdoshme jo vetëm bërja prezent e problematikës por, duhet të intesifikohen përpjekjet e institucionit për përsheptimin e marrjes së kësaj iniciative drejt Këshillit të Ministrave.

Menjëherë.

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi rezultoi se, struktura analitike e ISHP-së nr. 4295/1 prot., datë 11.10.2010, e zbatuar deri në fillim të gushtit 2012, parashikon profilet kërkimore - shkencore të personelit mjekësor. Sipas kësaj strukture përgjegjësat e departamenteve duhet të jenë të paktën me titull Doktor Shkencash, mjekët me profile të përcaktuar sipas departamenteve duhet të jenë kërkues shkencorë ndërsa, në strukturat nr. 2513 prot., datë 25.04.2012, nr. 1020/1 prot., datë 06.03.2013 dhe nr. 3578/1 prot., datë 26.08.2013, nuk parashikojnë punonjës me grada shkencore dhe punonjës kërkimor shkencor megjithatë, u konstatua se për vitet 2012 dhe 2013, me urdhër të Titullarit të institucionit, janë emëruar si kërkues pa gradë shkencore, në kundërshtim me ligjin nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, neni 15 “Funksionet”, germa c *“kërkimi shkencor në shëndetin publik”*, 20 punonjës **në shumën 6,269,961 lekë**, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, nga të cilët për vitin 2012, në

shumën 1,941,847 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 4,328,114 lekë pasi, janë punonjës pa gradë shkencore por, që janë paguar si punonjës kërkimor shkencor.

Për këtë është rekomanduar që:

Instituti i Shëndetit Publik të rishikojë emërimet punonjësve të kryera në vitet 2012-2013, që janë bërë në kundërshtim me Urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë nr. 511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” dhe nr. 305, datë 04.07.2012 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave për punësimin e punonjësve”, si dhe VKM nr. 589, datë 05.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012”, dhe në të ardhmen emërimet e punonjësve të bëhen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Përcaktimi i kriterëve apo, profileve të punonjësve kërkimorë të marrë parasysh jo vetëm titullin por, edhe lidhjen e fushës së kërkimit në të cilën është mbrojtur titulli me pozicionin e synuar në këtë Institucion, vetëm kështu do të arrihet të maksimizohet vlera e punës së tyre kërkimore dhe do të lidhet ajo me objektivat e Institucionit.

Menjëherë.

2. Nga auditimi në lidhje me marrjen në punë të punonjësve për vitet 2012-2013, rezultoi se, janë punësuar 7 punonjës për vitin 2013, ndërsa për vitin 2012 janë punësuar 9 punonjës, të cilët nuk i janë nënshtruar konkurrimit në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 511, datë 13.12.2011 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” ndërsa për 12 punonjës për vitin 2013 dhe 3 punonjës për vitin 2012, janë zbatuar procedurat e konkurrimit të hapur të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit por, nuk është zbatuar kriteri i vlerësimit me pikë të dokumentacionit të kandidatëve, nuk është bërë vlerësimi i intervistës dhe praktikës së konkurrimit nuk i është bashkëlidhur kopje e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati konkurrues për pozicionin e lirë.

Gjithashtu, për vitin 2012, janë punësuar 7 punonjës, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 305, datë 04.07.2012 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave për punësimin e punonjësve” dhe VKM nr. 589, datë 05.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012”, neni 3, ku citohet: *“Çdo funksion në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i miratuar në organikë dhe i paplotësuar ende, të ngrijë deri në fund të vitit. Përbërja nga ky kufizim vendet e paplotësuara, për të cilat është realizuar konkursi, si dhe rastet tepër specifike, për të cilat merret miratimi i Ministrit të Financave”*. Nuk ka miratim nga Ministri i Financave.

Përbërja e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve për pozicionet e lira, është caktuar me Urdhrat e Brendshëm nr. 306/1, datë 20.04.2012 dhe nr. 140/1, datë 16.02.2012, ku në përbërje komisionit është edhe Titullari i institucionit, që bie në kundërshtim me nenin 135, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pika 2, shkronja b.

Struktura organike e institucionit pas miratimit nga Ministri i Shëndetësisë, nuk është hartuar në mënyrë analitike. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik, krahas emërimeve të punonjësve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa që, pas miratimit të strukturës organike nga Ministri i Shëndetësisë, të hartojë dhe të miratojë strukturën organike të personelit në mënyrë analitike, për çdo departament dhe sektor, si dhe të përcaktohet pozicioni për çdo punonjës, duke përcaktuar pozicionin, pagën bazë dhe shtesat që duhet të përfitojnë bazuar në pozicionin që kanë, elemente të së cilës duhet të pasqyrohen dhe në listëpagesat përkatëse të punonjësve.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

3.1 Nga auditimi i konsumit të karburantit, u konstatua se, për vitin 2012, janë harxhuar 21,920 litra dhe për vitin 2013, janë harxhuar 22,420 litra. Fletët e udhëtimit për lëvizjet e

brendshme, nuk janë plotësuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi, nuk janë firmosur nga personat që kanë kryer lëvizjet e brendshme me mjetet e institucionit dhe në disa raste dhe nga vetë drejtuesi i mjetit, që bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 26, dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, por që tregon edhe për mungesë të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe lënie hapësirë për shpërdorime me këtë lloj malli. Sasia e karburantit **8,810 litra, në vlerën 1,585,800 lekë**, e konsumuar për lëvizje të brendshme, nuk justifikohet me dokumentacion të rregullt.

3.2 Nga auditimi i harxhimit të karburantit për vitin 2012, rezultoi se, të dy gjeneratorët si rezultat i ndërprerjes së energjisë elektrike kanë harxhuar 1,720 litra naftë ose, mesatarisht çdo muaj 140 litra ndërsa, për vitin 2013, kanë harxhuar 930 litra naftë ose, mesatarisht çdo muaj 78 litra. Përdorimi i karburantit për të dy gjeneratorët përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore pasi, nuk është mbajtur asnjë dokument apo grafik nga një komision i posaçëm, që të vërtetojë ndërprerjen e energjisë elektrike.

3.3 Nga auditimi rezulton se, titullari i institucionit nuk ka nxjerrë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, administrimin dhe përdorimin e karburantit dhe se, nuk është ngritur komisioni për matjen e harxhimit të karburantit për çdo 100/ km, për 11 mjetet e institucionit që janë në përdorim. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat e duhura, për ngritjen e sistemeve të kontrollit me qëllim disiplinimin e shpenzimeve të karburantit dhe për matjen e normativës së konsumit të karburantit për çdo mjet për 100 km, të ngrejë komisionin në përbërje të së cilit të jenë dhe specialistë të fushës ndërsa, për harxhimin e karburantit nga të dy gjeneratorët, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike, të ngrejë një komision të posaçëm i cili të dokumentojë me procesverbal ndërprerjen energjisë elektrike.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

4. U konstatuan, mangësi dhe shkelje në respektimin e rregullave dhe disiplinën financiare në plotësimin e dokumentacionit ku, në disa raste urdhër shpenzimet ishin pa numër dhe pa datë, në mjaft raste faturat tatimore ishin pa datë dhe pa firmën e marrësit në dorëzim. Në të gjitha rastet e kryerjes së shërbimeve nga institucioni, nuk janë mbajtur procesverbalet për kryerjet e shërbimeve, apo aktkolaudimet përkatëse për të vërtetuar kryerjen e shërbimeve dhe se, për riparimin e mjeteve nuk janë bërë hyrje në magazinë pjesët e ndërrimit, praktika në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik të eliminojë rastet e pagesave të shërbimeve apo, blerjes së mallrave pa plotësuar dokumentacionin përkatës justifikues në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe specifikisht për riparimin e mjeteve pjesët që zëvendësohen të bëhen hyrje në magazinë.

Vazhdimisht.

5. Për vitin 2013, inventarizimi i aktiveve është kryer sipas Urdhrit nr. 444, datë, 30.12.2013, por në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 7 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, inventarizimi për aktivet e qëndrueshme është kryer vetëm për inventarin ekonomik. U konstatua se përgjegjësi material është në komisionin e inventarizimit. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat që, çdo vit të kryejë inventarizimin e të gjithë pasurisë së institucionit, duke përfshirë dhe aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe për çdo rast të ngritjes së komisionit të inventarizimit, në përbërje të tij, nuk duhet të jenë personat që kanë konflikt interesi dhe se, punonjësi që ka në ngarkim apo, në përdorim aktivin, nuk duhet të marrin pjesë në komision por, ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi.
- Për mjetet e transportit që nuk janë në gjëndje pune, institucioni të marrë masat për të ngritur komisionin e vlerësimit të këtyre mjeteve nëse mund të riparohen, të transferohen apo, të shiten për skrap. Komisioni të vlerësojë edhe shkaqet e nxjerrjes jashtë funksionit të këtyre mjeteve duke përcaktuar dhe përgjegjësi materiale nëse konstatohet.

Vazhdimisht.

6.1. Nga autoriteti kontraktor, për tenderat e zhvilluar janë nxjerrë shkresat zyrtare për caktimin e komisioneve të specializuara, për të përcaktuar specifikimet teknike. Lidhur me përllogaritjen e fondit limit duhet të theksojmë, se kanë qenë formale dhe jo të rregullta, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”.

6.2. Grupet e punës për përllogaritjen e fondit limit, shprehen me fjalë në procesverbal për përllogaritjen e fondit limit, bazuar në ofertat e paraqitura në një vit më parë, duke u mjaftuar me një tabelë pa dhënë komente të detajuara, gjithashtu sasia e nevojshme e artikujve nuk pasqyrohet në bazë të kërkesave dhe domosdoshmërinë. Autoriteti Kontraktor, nuk ka bërë përllogaritjen e vlerës së fondit limit sipas kritereve të përcaktuara në pikën 2 të VKM-së, nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, pasi përllogaritja e fondit limit është bazuar vetëm në mesataren e ofertave dhe jo në çmimet e kontratave të mëparshme dhe nuk kanë hulumtuar në çmimet e tregut, për të siguruar një fond limit koherent llogaritur në të dhe inflacionin e mundshëm.

6.3. Në dosjen e tenderit, sidomos në procedurat Kërkesë për propozim, nuk argumentohet përzgjedhja dhe dërgimi i ftesës për ofertë kandidatëve që operojnë në këtë fushë, si dhe nuk dokumentohet mënyra e dërgimit të ftesës operatorëve pjesëmarrës pasi, në asnjë dokumentacion që administrohet në dosjen e prokurimit nuk argumentohet pamundësia për arsye teknike, ose mungesa e operatorëve të tjerë ekonomikë që operojnë në këtë fushë, duke ju referuar edhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007 dhe ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, neni 33, pika 1, ku cilësohet “...Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës, ose në diskriminimin e kandidatëve”. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Autoriteti Kontraktor, në përllogaritjen e fondit limit të mallrave apo, shërbimeve të cilat kanë natyrë të njëjtë dhe për shumë institucione të varësisë nga Ministria e Shëndetësisë, të mos kufizohet në tre oferta tregu apo, në kontratën e mëparshme por, ti drejtohet me shkresë Drejtorisë së Prokurimeve në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me çmimet e kontratave të lidhura nga institucionet e tjera, për një përllogaritje më të saktë të fondit limit.

- Autoriteti Kontraktor, në dokumentet e tenderit duhet të vendosi kritere që duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

- Në prokurimin e fondeve të zhvillohen procedurat e prokurimit procedurë “e hapur” dhe procedurat “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës emergjencë”, dhe në rastet e përdorimit të procedurave të tjera, kryesisht “kërkesë për kuotim”, të bëhet një argumentim rigoroz për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

Vazhdimisht.

7. U konstatua se, marrja në dorëzim e automjeteve pas riparimit, nga komisioni i ngritur me urdhër të Titullarit të institucionit, është bërë formal duke firmosur situacionet dhe procesverbalet e punimeve pa verifikuar numrin ose kodin e skemës origjinale të montimit, numri ose kodi original i referencës për pjesën e këmbimit të kërkuar të nevojshme për montim gjatë riparimit të mjetit, si dhe numrin ose pozicionin e pjesës së këmbimit në skemën e montimit, si dhe origjinën e pjesëve të këmbimit të përdorura, sipas furnizimeve të bëra nga firma prodhuese, ose tregëtuese të pjesëve të këmbimit, kërkesa të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në situacionet e firmosura nga komisioni janë të shënuara emri i pjesës së këmbimit, sasia, çmimi dhe vlera, pa shënuar asnjë referencë për sa shprehet më sipër. Gjithashtu mungojnë urdhrat e punës, ku të jetë shënuar identiteti, numri i fletdaljes së magazinës për pjesët e këmbimit të tërhequra për riparim, dhe lloji i profesionit të personit që ka kryer riparimin, si xhenerik, motorrist, elektroauto, origjina e blerjes së pjesëve të këmbimit, etj. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës, për të bërë verifikimet e duhura pranë subjektit “Auto serviss 2000 shpk”, në lidhje me riparimet e kryera për çdo automjet, duke kërkuar dokumentacionin e brendshëm qarkullues, garanci për punët e realizuar, duke filluar nga urdhrat e punës, fletë daljet e pjesëve të këmbimit të tërhequra nga magazina për çdo riparim, origjinalitetin e pjesëve të këmbimit, si dhe skicat e përdorura në montim.

Menjëherë.

8. U konstatua se, për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe pajisjeve të prokuruar, nga ana e komisioneve të kolaudimit bëhet një punë formale pasi, procesverbalet dhe fletët e kolaudimit nuk kanë të dhëna për karakteristikat e mallit origjinën, emrin e firmës prodhuese të cilat janë të detyruara të shënohen gjatë kolaudimit pasi, kanë qenë pjesë e kërkesave në procedurat e prokurimit, ku në mjaft raste janë kërkuar autorizimet e prodhuesit ose autodeklaratat.

Autoriteti Kontraktor, duke qenë se, në të gjitha procedurat e prokurimit për blerjen e materialeve të konsumit për laboratorët, etj, në kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqisin certifikatat CE dhe ISO, **është rekomanduar që:**

Në kontratat e lidhura për pajisjet me firmat fituese, ky dokumentacion të jetë dokumentacion shoqëruar në lëvrimin e mallit. Gjykojmë se, certifikata e cilësisë dhe origjinës së mallit, duhet të jenë pjesë integrale e kontratës. Ky dokumentacion është i domosdoshëm pasi, garanton cilësinë, origjinalitetin e mallit dhe shmang spekulimet në cilësinë e mallrave.

Vazhdimisht.

9. Lidhur me konstatimin për projektin “*Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Qasjes Strategjike për Menaxhimin Ndërkombëtar të Kimikateve (SAICM) në Shqipëri*”, për të cilin nuk disponohej dokumentacioni i plotë për shpenzimet e karburantit për justifikimin e **shumës 7,016 USD**, rekomandojmë që të plotësohet dokumentacioni për justifikimin e kësaj shume dhe për vlerën e karburantit që nuk do justifikohet me dokumentacion, të kërkohet zhdëmtimi nga personat përgjegjës.

Menjëherë.

10. Nga auditimi mbi llogaritjen e amortizimit u konstatua se, ka pasaktësi në shumën e paraqitur në pasqyrat financiare kështu për vitin 2013, *amortizimi* për zërin “Pajisje kompjuterike”, duhet të pakësohet për vlerën **3,801,718 lekë**, për zërin “Pajisje, makineri”, duhet të pakësohet për vlerën **3,341,422 lekë**, për zërin “Mobilje laboratorit dhe pajisje

mobilitet zyrtar”, duhet të pakësohet për vlerën **757,491 lekë**, për zërin “Kafshë pune e prodhimi”, duhet të pakësohet për vlerën **838 lekë** dhe zërin “Inventar ekonomik”, duhet të shtohet për vlerën **5,608 lekë**. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa që Sektori i Financës, bëjë saktësime të amortizimit të paraqitur në pasqyrat financiare dhe të saktësojë evidencën e mbajtur në të ardhmen për këtë zë të pasqyrave financiare.

Menjëherë.

11. Nisur nga problematika e mbajtjes së regjistrit të aktiveve që ka në administrim Instituti i Shëndetit Publik, jo në përputhje me të gjithë kërkesat minimale të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, **është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik, të marrë masa të menjëhershme për të plotësuar regjistrin e aktiveve, në përputhje me pikat 26 dhe 30 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vendodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, etj.

Deri më 31.12.2014.

12.1. Nga auditimi rezultoi se, vaksinat apo, shiringat bëhen hyrje në magazinë, mbi bazën e faturës dhe procesverbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallit i cili në procesverbal përshkruan sasinë e mallit, vlerën në dollarë, kursin e këmbimit dhe çmimin për njësi në lekë. Gjatë konvertimit të vlerës së mallit nga dollarë në lekë, për të nxjerrë çmimin në lekë për njësi, ka pasur diferencë të vogla më shumë apo më pak, me argumentimin e rrumbullakosjes së çmimit.

12.2. Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe, raportojnë për gjendjen e vaksinave në fund të çdo tremujori por, nuk dërgojnë paraprakisht kërkesat për tremujorin pasardhës dhe se, kërkesat për vakcina jashtë planifikimit, jo gjithmonë dërgohen me shkrim për të dhënë arsye të përkatëse që mund të vijnë si rezultat i lëvizjes së fëmijëve, nga njëri rreth në tjetrin apo i kthimit të familjeve nga jashtë shtetit.

12.3. Nga auditimi rezultoi se, gjatë furnizimit me vakcina të Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe, fletë daljet e magazinës së institucionit, nuk kanë të bashkëngjitur fletë hyrjet e magazinës të Drejtorive të Shëndetit Publik me qëllim që të vërtetohet hyrja e vaksinave në magazinat e tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Komisioni i marrjes në dorëzim të vaksinave apo, shiringave i cili nxjerr çmimin për njësi, të caktojë drejt çmimin për njësi dhe në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike, Sektori i Financës të bëjë sistemimet përkatëse.

-Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa dhe tu kërkojë Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe që, përveç raportimit për gjendjen e vaksinave në fund të çdo tremujori, paraprakisht duhet të dërgojnë dhe kërkesat për tremujorin pasardhës në mënyrë që planifikimi të ndjekë trendin e kërkesave sipas rajoneve dhe që për kërkesat jashtë planifikimit të kërkohet dërgimi me shkrim i kërkesës së bashku me argumentimin përkatës për shtesat e kërkuara.

-Të merren masa që, për çdo dalje që do të bëhet nga magazinat lidhur me furnizimi me vakcina të Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe, fletë daljeve të magazinës të bashkëngjiten fletë hyrjet e magazinës së Drejtorive të Shëndetit Publik, me qëllim që të bëhet çiftimi i

dokumentave dhe të vërtetohet hyrja e vaksinave, kjo do të eliminojë edhe mundësinë për veprime fiktive.

Vazhdimisht.

13. Nga auditimi u konstatua se me Urdhrin e Brendshëm të Titullarit nr. 325, datë 27.12.2012, është ngritur komisioni i inventarizimit për magazinën e vaksinave në përbërje të të cilit është edhe përgjegjësi i vlerave materiale (magazinjeri) i cili ka në ngarkim vaksinat. Është mbajtur procesverbali i datës 31.12.2012, për nxjerrjen e vaksinave jashtë përdorimit në vlerën 28,119,164 lekë. Konstatuam se, vlerën më të madhe 22,966,500 lekë, pra rreth 82% të vlerës totale të vaksinave të nxjerra jashtë përdorimit e zë vaksina AH1N1, vaksina ndaj Gripit Pandemik, i cili është tepër i rrallë dhe emergjencë ndërkombëtare. Sasia e nxjerrë jashtë përdorimi është asgjësuar sipas urdhrin të titullarit dhe me procesverbal agjësimit nr. 325/2, datë 07.01.2013. **Për këtë është rekomanduar që:**

Duke qënë se vlera e asgjësimit është shumë e madhe dhe procedura ka elementë formal i kërkojmë institucionit të përcaktojë një protokoll të qartë lidhur me evidentimin e vaksinave të skaduara, vendin e konstatimit të tyre, datën e skadimit, shkakun e skadimit dhe mënyrën e raportimit të këtij informacioni. Në rastin e verifikimit të vaksinave të skaduara të merret miratimi i Ministrisë së Shëndetësisë për asgjësimin e tyre, asgjësim që do të kërkojë një nivel të lartë transparence të këtij procesi si dhe mbikqyrjen nga Ministria e Shëndetësisë.

Vazhdimisht.

14. Nga auditimi rezultoi se, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe 65, dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitet 2012 dhe 2013, institucioni nuk ka hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program. **Për këtë është rekomanduar që:**

:

Instituti i Shëndetit Publik të hartojë dhe të dërgojë në Ministrinë e Shëndetësisë, raportet e monitorimit të buxhetit që duhet të përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiore dhe vlerorë të produkteve të realizuara, të identifikojnë mosarritjet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre, duke propozuar dhe masa për përmirësimin e situatës.

Çdo 3 muaj dhe në fund të vitit.

15. Nisur nga konstatimi se projekti “Për vlerësimin e pamjaftueshmërisë jodike gjatë periudhës 2012-2013, ka përfutur fonde nga AKTI, jo në përputhje me qëllimet që kanë fondet për financim nga ky institucion (gjykojmë se studimi që kryhet në mënyrë të vazhdueshme duhet të përfshihet në një nga detyrat që duhet të kryhej vetë ISHP), por edhe fonde nga UNICEF-i, për një studim me shtrirje në të njëjtën periudhë kohore dhe pothuaj në të njëjtat prefektura, duke mos bërë një planifikim të mirë dhe efektiv të fondeve të donuara. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana institucionit të përcaktohen jo vetëm studimet dhe fushat prioritare në kërkim, por dhe bashkërendimi i punës dhe përpjekjeve që fondet e donatorëve të sjellin përfitueshmëri maksimale jo vetëm për institucionin, por kryesisht për arritjen e objektivave të tij në fushën e kërkimit.

Vazhdimisht.

16.1. Nga auditimi rezultoi se, ndryshimi i strukturës dhe organikës së njësisë miratuar nga Ministri i Shëndetësisë nr. 3578/1, datë 26.08.2013, nuk është shoqërura me ndryshimin e rregullores së brendshme të njësisë pasi, ka mospërputhje midis rregullores dhe strukturës organike.

16.2. Nga auditimi u konstatua se, njësia nuk ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik i cili përmban objektivat strategjik, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit, kjo në kundërshtim ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

16.3. Njësia nuk ka një Kod Etik të veçantë, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

16.4. Njësia nuk ka rregulla të brendshëm të miratuara nga titullari, të cilët trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

16.5. Njësia nuk ka identifikuar dhe krijuar regjistrin e riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të institucionit me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojnë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, të hartojë dhe propozojë tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik, duke e azhurnuar atë çdo vit, duke përcaktuar me kujdes objektivat strategjike, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Instituti i Shëndetit Publik, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Kodin Etik, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave.

-Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masa e duhura për të identifikuar dhe krijuar regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Deri më 31.10.2014.

17. Njësia ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme që përcakton detyrat specifike dhe përgjegjësitë për çdo strukturë por, njësia nuk ka bërë vlerësimin periodik apo, vjetor të punës së punonjësve. Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, nuk kanë njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për pasojë nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të

administratës, duke përfshirë dhe trajnimin për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualit të dalë në zbatim të tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës.

Deri më 31.10.2014.

18. Auditimi konstatoj se, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim të ndihmojnë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë hapësirat, etj. **Për këtë është rekomanduar që:**

Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Deri më 31.10.2014.

19. Nga auditimi u konstatua se, sistemi i IT-së në institucion është i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ripërfitimin e tyre në rast aksidenti por, deri me sot, ku sistem garanton të dhënat e sistemit të financës, të dhënat mbi mbulesat vaksinale (SIV), të analizave të ujit të pijshëm, të skedave individuale për difektet e lindura dhe sistemin Alert, pra nuk mbulon të gjithë funksionet për të cilat kërkohet raportim. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik, të marrë masa që në ardhmen sistemi i IT-së, të garantojë sigurinë e të dhënave për të gjithë format e raportimit që mbulon institucioni.

Deri më 31.12.2014.

20. Nga auditimi rezultoi se, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V "Shtojcat", Shtojca 2 – Pyetësi i vetë-vlerësimit për komponentet e MFK-së, njësia nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë pyetësin e vetëvlerësimit ku citohet se: *"I rekomanohet Titullarit të njësisë që të detyrojë drejtuesit e tjerë të strukturave të njësisë të plotësojnë këtë pyetësor për strukturat që kanë në përgjegjësi. Titullari i njësisë do të përdorë rezultatet për të formuluar një përgjigje të plotë, në lidhje me gjithë subjektin..."*. **Për këtë është rekomanduar që:**

Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa e duhura që në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë në Ministrinë e Shëndetësisë pyetësin e vetë-vlerësimit me qëllim që të ndihmojë njësinë në indentifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësimit i mëtejshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

Çdo vit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Instituti i Shëndetit Publik, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, **në shumën 6,269,961 lekë**, për 20 punonjës, nga të cilët për vitin 2012, në shumën 1,941,847 lekë dhe për vitin 2013, në shumën 4,328,114 lekë pasi, janë punonjës pa gradë shkencore por, që janë paguar si punonjës kërkimor shkencor.

Menjëherë.

2. Instituti i Shëndetit Publik, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, për konsumin e 8,810 litrave karburant **në shumën 1,585,800 lekë**, nga

Përgjegjësi i Administratës z. ■ dhe N/Drejtores Ekonomike znj. ■, të cilët me mosveprimin e tyre kanë lejuar konsumin e kësaj sasive me mungesë të plotë dokumentacioni, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 26, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

Menjëherë.

3. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, ***në shumën 368,100 lekë***, nga 45 punonjës, për sa pagur padrejtësisht për udhëtim e dieta brenda vendit, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.

Menjëherë.

4. Instituti i Shëndetit Publik, të marrë masa për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për 37 punonjës, ***në shumën 293,999 lekë***.

Menjëherë.

5. Instituti i Shëndetit Publik, të marrë masa për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për 31 punonjës, ***në shumën 137,483 lekë***, për mos mbajtjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për raportet, mjekësore deri në 14 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 “Periudha e përfitimit”.

Menjëherë.

6. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, ***në shumën 92,000 lekë***, për sa pagur me tepër 10 persona, për organizimin e drekës për projektin “SAICM” pasi, kanë marrë pjesë 31 persona dhe janë paguar 41.

Menjëherë.

7. Instituti i Shëndetit Publik, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, ***në shumën 27,273 lekë***, nga z. ■ i cili është paguar padrejtësisht për 15 ditorin e dytë të muajit gusht 2012, duke mos qenë prezent në kohëshënuesin e departamentit pasi, urdhri i emërimit në detyrë ka dalë me datë 04.09.2012.

Menjëherë.

8. Instituti i Shëndetit Publik, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, ***në shumën 313,800 lekë***, nga kompania ■, e cila ***nuk ka dorëzuar mallin sipas specifikimeve të parashikuara në kontratën*** nr. 674/10, datë 18.09.2012, që është bërë hyrje në magazinë me Fletë Hyrjen nr. 111, datë 30.11.2012, në bazë të Faturës nr. 542, datë 30.11.2012.

Menjëherë.

9. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimit të dëmit ***në shumën 319,000 lekë***, pasi si rezultat i kryqëzimit të të dhënave midis lëvizjeve të shoferave në dispozicion të projekteve në të cilat ata rezultojnë me shërbim dhe kanë përfituar dieta, si dhe fletë udhëtimeve të plotësuar për lëvizjet e brendshme në dispozicion të administratës së ISHP-së, për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar, rezultoi se, shoferat e ISHP-së, ***janë në dy vendodhje në të njëjtën ditë dhe***

përshkrojnë km të ndryshme, në të njëjtën kohë, që fletë udhëtimet e tyre pasqyrojnë lëvizje në Tiranë, duke përfitur padrejtësisht shumën e mësipërme, në kundërshtim me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, si dhe në kundërshtim të plotë me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë.

10. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në shumën 2,233 Euro, nga personat e përfshirë në projektin “*New Model for Raising Breast Cancer Awareness in Albania*” 2010-2012 pasi, nga pagesat rezulton se, megjithë ushqimi është i mbuluar dhe paguar rezulton se, janë shpenzuar për ushqim nga personat e trajnuar dhe rimbursuar në shumën e mësipërme, shumë e cila nuk duhej rimbursuar pasi, shpenzimet e ushqimit kanë qenë mbuluar nga organizatorët, si dhe pasqyrohet në shpenzimet e kryera.

Menjëherë.

11. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në shumën 176,000 lekë, nga personat e përfshirë në projektin “*Vlerësimi i pamjaftueshmërisë jodike gjatë periudhës 2012-2013*”, të cilët kanë përfitur dieta më shumë se data e mbylljes së shërbimit.

Menjëherë.

12. Instituti i Shëndetit Publik të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimit të dëmit në shumën 82,500 lekë, nga personat përfitues në projektin “*Monitorimi i ujit të detit financiar nga Ministria e Mjedisit*”, të cilët kanë përfitur shpenzimet e dietave, për vendodhje larg qendrës së punës nën 100 km, në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.

Menjëherë.

D. MASA DISIPLINORE.

Në bazë të nenit 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për mangësitë dhe parregullsitë e trajtuara në Raportin e Auditimit, i rekomandohet Titullarit të institucionit të analizojë parregullsitë e konstatuara, të nxjerrë personat shkaktarë përgjegjës dhe marrë masa disiplinore për punonjësit përgjegjës bazuar në trajtimet e bëra në këtë Raport Auditimi.

Për shkeljet e konstatuara në administrimin e vlerave materiale e monetare propozojmë masë “*Largim nga puna*”, për :

1. Znj. ■ me detyrë N/Drejtoresh Ekonomike për:

a. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, ku citohet: “*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin*

*dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve”, në Institutin e Shëndetit Publik për vitet 2012-2013, janë harxhuar për lëvizje të brendshme **8,810 litra karburant ne vlerën 1,585,800 lekë**, që nuk justifikohet me dokumentacion të rregullt dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Për këtë mban përgjegjësi N/Drejtori Ekonomik znj. ■ pasi, në bazë të Rregullores së Brendshme nr. 5, datë 04.01.2011, një ndër funksionet e N/Drejtorit Ekonomik është ndjekja e administrimit të vlerave materiale të ISHP-së, si dhe propozon masa administrative e disiplinore për keqpërdoruesit e bazës materiale teknike.*

b. Për shkeljet e konstatuar në llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore si më poshtë:

Në llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për punëdhënësin dhe punëmarrësit nuk janë zbatuar VKM nr. 477, datë 30.03.2010 dhe VKM 541, datë 27.01.2011, pra për vitet 2011 – 2012, nuk është reflektuar rritja e kufirit maksimal. Nga mosrespektimi i kufirit maksimal për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezulton se, janë derdhur më pak kontribute nga punëdhënësi dhe punëmarrësi.

c. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2013 janë paguar me raport mjekësor nga institucioni për 14 ditë punonjësit, të cilëve nuk u është mbajtur kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën lekë **137,483** lekë.

2. Z. ■ me detyrë Përgjegjës i Administratës për:

Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, ku citohet: “*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vertetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve”, në Institutin e Shëndetit Publik për vitet 2012-2013, janë harxhuar për lëvizje të brendshme **8,810 litra karburant ne vlerën 1,585,800 lekë**, që nuk justifikohet me dokumentacion të rregullt dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe mban përgjegjësi z. ■, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Administratës.*

Për znj. ■ me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, znj. ■ me detyrë specialiste finance dhe znj. ■ me detyrë ekonomiste, i lihet në kompetencë Titullarit të institucionit të marrë masa disiplinore sipas përgjegjësive të konstatuara në këtë Raport Auditimi.

E. PROPOZIME PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

MASA ADMINISTRATIVE DHE DISIPLINORE

1. Në bazë të neneve 13 dhe 72 të LPP, të ndryshuar, të merren në analizë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për anëtarët e Njesisë së Prokurimit Publik, znj. ■ - anëtare, z. ■ – anëtar, znj. ■ – juriste, si dhe z. ■ ish-Kryetar i Autoritetit Kontraktor (për vitin 2012), me specialistët e fushës dhe llogaritjes së fondit limit, z. ■ (për

vitin 2012) dhe z. ■ dhe z. ■ (për vitin 2013), me specialistët e fushës dhe llogaritjes së fondit limit **znj. ■, znj. ■, z. ■**, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e Prokurimit Publik, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse për mangësitë dhe shkeljet, si më poshtë vijon:

Për mosrespektim të rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat përbëjnë kundravajtje administrative pasi, në tenderat e audituar, janë konstatuar mangësi e shkelje të njëjta të rregullave të prokurimit publik, ku më kryesorët përmendim:

1. Nga Autoriteti Kontraktor për tenderat e zhvilluar ka nxjerrë shkresat zyrtare për caktimin e komisioneve të specializuara, për të përcaktuar specifikimet teknike. Lidhur me përllogaritjen e fondit, rezultoi se, kanë qenë formale dhe jo të rregullta në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, dispozitë që lidhet direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa “a” ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime. **Theksojmë se, zërat e parashikura për furnizim vendosje për çdo makinë në tenderin e riparimeve të automjeteve janë të njëjta për të dy vitet 2012-2013, ku e njëjta makinë çdo vit kryen të njëjtat ndërrim pjesësh, si rrip motori, koka zbarash, grup timoni, sinjale të pasme, etj. Asnjë makinë e ISHP-së, nuk kryen shërbime të natyrave të zakonshme që kryen një makinë, si filtra, vaj apo dhe difekte të ndryshme që mund të ndodhi.**

2. Grupet e punës për përllogaritjen e fondit limit, shprehen me fjalë në procesverbal për përllogaritjen e fondit limit, bazuar në ofertat e paraqitura në një vit më parë, duke u mjaftuar me një tabelë pa dhënë komentet të detajuara. Gjithashtu, sasia e nevojshme e artikujve nuk pasqyrohet në bazë të kërkesave dhe domosdoshmërinë, por evidentohet se, sasia është kërkuar po aq sa edhe në vitin 2011, veprim në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007. Autoriteti Kontraktor, nuk ka bërë përllogaritjen e vlerës së fondit limit, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, pasi përllogaritja e fondit limit është bazuar vetëm në mesataren e ofertave dhe jo në çmimet e kontratave të mëparshme dhe nuk kanë hulumtuar në çmimet e tregut për të siguruar një fond limit koherent, llogaritur në të dhe inflacionin e mundshëm. Mungon analiza e kostos së mallrave nga Njësia e Prokurimit, duke mos u dokumentuar në se është bërë ose jo, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 2/ç “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa ç, ku thuhet “... Analizon kostot e mallrave dhe në çdo rast i dokumenton ato”, veprim që ngarkon me përgjegjësi Grupin e punës.

3. Në dosjen e tenderit, sidomos në procedurat “Kërkesë për propozim”, nuk argumentohet përzgjedhja dhe dërgimi i ftesës për ofertë kandidatëve që operojnë në këtë fushë, si dhe nuk dokumentohet mënyra e dërgimit të ftesës operatorëve pjesëmarrës pasi, në asnjë dokumentacion që administrohet në dosjen e prokurimit, nuk argumentohet pamundësia për arsye teknike, ose mungesa e operatorëve të tjerë ekonomikë që operojnë në këtë fushë, duke ju referuar edhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007 dhe ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, neni 33, pika 1 cilësohet “...Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës, ose në diskriminimin e kandidatëve”.

4. Duhet të theksojmë se, Autoriteti Kontraktor nuk ka bërë një parashikim të saktë të nevojave për mallra e shërbime, bazuar kjo në numrin e madh të shtesave për nevoja për fillim viti, të cilat janë pothuajse për gjithë kontratat e lidhura një vit më parë.

5. Autoriteti Kontraktor, në të gjitha procedurat e prokurimit për blerjen e materialeve të konsumit për labororet, etj., në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin: autorizim nga firma prodhuese e cila autorizon firmën

ofertuese për të ofruar produktet e saj në tendër CE dhe ISO, si dhe për pajisjet e ofruara duhet që, në dokumentacionin që do të paraqesë firma fituese, gjatë lëvrimin të mallit të përfshihen deklarata doganore, fatura e shitësit nga është importuar malli, certifikata e cilësisë dhe origjinës së mallit, të cilat duhet të jenë pjesë integrale e kontratës. Ky dokumentacion është i domosdoshëm, pasi garanton cilësinë, origjinalitetin e mallit dhe shmang spekulimet në cilësinë e mallrave.

- Cilësojmë se, në të gjitha tenderat e zhvilluar kërkesa kualifikuese kapacitetit teknik është kërkuar dokumenti: *“Kërkohet autodeklaratë nga OE për origjinën e mallit dhe firmën prodhuese”*. Kjo kërkesë nuk është e plotë pasi, lidhur me Origjinën e mallrave ka dokumentacion tjetër i cili vërtetohet lehtë dhe nuk mund të lihet thjesht në një autodeklaratë.

- Cilësojmë se, në të gjitha tenderat e zhvilluar, nuk është kërkuar kërkesa kualifikuese, që është tepër e domosdoshme për tu paraqitur nga konkurrentët, e konkretisht *“Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve”*. Kjo kërkesë kualifikuese e veçantë i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Si rrjedhim, një operator me bilanc ekonomik negativ, për një periudhë trevjeçare, mund të shërbejë si tregues për paaftësinë e këtij operatori ekonomik, për përmbushjen e kontratës.

- Është kërkuar si kërkesë kualifikuese: *“furnizime të ngjashme ... Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratën përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/tyre nga autoriteti kontraktor”*, kontrata edhe mund të lidhet dhe nuk zbatohet, si dhe vërtetimi i dhënë, nuk është një dokument që regjistrohet në kontabilitet, prandaj duhet kërkuar fatura tatimore, si dhe urdhër shpenzimi i likuiduar, dokumente të cilat janë të regjistruar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare si dhe të shoqëruara edhe me vërtetimin për realizimin me sukses të tyre.

Këto kërkesë kualifikuese, nuk janë konformë rregullave të prokurimit publik, pasi duhet të ishte kërkuar si dokument prove më të besueshme, certifikatë e origjinës së mallit dhe autorizim i prodhuesit dhe jo autodeklaratë të operatorit teknik.

6. Nuk janë marrë masat, për të siguruar ndarjet e detyrave nga punonjësi i autorizuar i Autoritetit Kontraktor nga titullari i Autoritetit Kontraktor, të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit (njësisë së prokurimit) dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Moskryerja e këtij veprimi bie ndesh me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “a”, që cilëson: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit ... Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për zyrtarin e autorizuar prej titullarit të autoritetit kontraktor kryhen në respektim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

7. Autoriteti Kontraktor, nuk u ka kthyer përgjigje apo liruuar sigurimet e ofertave operatorëve ekonomik pjesëmarrës në konkurrim, të cilët nuk janë shpallur fitues. Pra, në dosje nuk ka asnjë dokument përkatës, në respekt të kësaj kërkesë. Ky veprim bie ndesh me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 2, germa “e”.

Madje edhe në DST, pika 2.5 cilësohet: *“Autoriteti kontraktor rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës”*.

8. Raportet përmbledhëse të vlerësimit të procedurave të prokurimeve, që u janë dërguar për miratim Titullarit të Autoritetit Kontraktor, janë nënshkruar vetëm nga Kryetari i KVO-së, në një kohë që duhet të ishin nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO-ve. Një kërkesë e tillë është cilësuar në VKM nr. 1, datë 10/01/2007, i ndryshuar, Kreu V-Zhvillimi i procedurave,

pika 4-Hapja dhe vlerësimi i ofertave, germa (gj), që cilëson: “... Komisioni i vlerësimit pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon, për miratim, titullarit të autoritetit”.

9. Formularët e konfliktit të interesit të plotësuar nga anëtarët e KVO-ve, kanë datën e momentit të nxjerrjes së Urdhër Prokurimit, në një kohë që duhej nënshkruar në momentin e datës së hapjes së zhvillimit të tenderave, siç përcaktojnë rregullat e prokurimit publik, e konkretisht VKK nr. 1, datë 10/01/2007, me ndryshimet, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, germa (a), që cilëson: “Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë përmes të cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit”.

Pra, anëtarët e KVO-ve, marrin pjesë fillimisht në proceset e prokurimit, vetëm në datat e hapjes së procedurave.

Gjithashtu, procesverbalet për vlerësimin e ofertave ekonomike dhe dokumentacioneve të konkurruesve të paraqitur në konkurrim janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, në një kohë, që duhej të ishin nënshkruar vetëm nga anëtarët e KVO-ve dhe personi i Njësisë së Prokurimit Publik, që ka mbajtur procesverbalet.

10. U konstatua se, marrja në dorëzim e automjeteve pas riparimit nga komisioni i ngritur me urdhër të Titullarit të institucionit, është bërë formal duke firmosur situacionet dhe procesverbalet e punimeve pa verifikuar numrin ose kodin e skemës origjinale të montimit, numri ose kodi origjinal i referencës për pjesën e këmbimit të kërkuar të nevojshme për montim gjatë riparimit të mjetit, si dhe numrin ose pozicionin e pjesës së këmbimit në skemën e montimit, si dhe origjinën e pjesëve të këmbimit të përdorura, sipas furnizimeve të bëra nga firma prodhuese, ose tregtuese të pjesëve të këmbimit, kërkesa të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në situacionet e firmosura nga komisioni janë të shënuara emri i pjesës së këmbimit, sasia, çmimi dhe vlera, pa shënuar asnjë referencë për sa shprehet më sipër.

Gjithashtu mungojnë urdhrat e punës, ku të jetë shënuar identiteti, numri i fletëdaljes së magazinës për pjesët e këmbimit të tërhequra për riparim, dhe lloji i profesionit të personit që ka kryer riparimin, si xhenerik, motorrist, elektroauto, origjina e blerjes së pjesëve të këmbimit, etj. Pra, nuk del qartë nëse, realisht janë kryer të gjitha riparimet sipas zërave të përcaktuara në aneksin e kontratës, për çdo automjet, apo ka abuzime në punimet e kryera.

Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për riparimin e automjeteve të vitit 2012.

11. U konstatua se, për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe pajisjeve të prokuruar, nga ana e komisioneve të kolaudimit bëhet një punë formale pasi, procesverbalet dhe fletët e kolaudimit, nuk kanë të dhëna për karakteristikat e mallit, origjinën, emrin e firmës prodhuese të cilat janë të detyruara të shënohen gjatë kolaudimit pasi, kanë qenë pjesë e kërkesave në procedurat e prokurimit, ku në mjaft raste janë kërkuar Certifikatat ISO dhe autorizimet e prodhuesit ose autodeklaratat. Këto kërkesa janë pasqyruar në kontrata në nenin (Detyrimet dhe të drejtat e kontraktuesit dhe autoritetit kontraktor), ku në përputhje me, specifikimet teknike të mallit kërkohet:

Cilësia dhe specifikimet teknike të mallit do të jenë ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të pranuar nga kontraktuesi në dokumentet e ofertës, të paraqitura nga ky operator ekonomik në tenderin e zhvilluar. Në të gjitha procesverbalet e komisionit të kolaudimit thuhet se, mallrat janë konformë specifikimeve e kushteve teknike të kontratës.

Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

F. KALLZIM PENAL

Për z. ■ me detyrë Përgjegjës i Administratës, për shkeljet e konstatuara në kundërshtim me dispozitat ligjore, si më poshtë:

I. Për procedurat e prokurimit publik.

1. Për vitin 2012, në tenderin me objekt **“Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh”**, me fondi limit 1,195,400 lekë, pa tvsh dhe vlera kontratës të lidhur 1,084,260 lekë, me tvsh.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhrin nr. 28 prot., datë 10.02.2012, ka emëruar Komisionin për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga dy specialistë, por nuk ka bërë një relacion përkatës për të treguar specialitetin e tyre të fushës, në fakt të dy personat nuk janë të fushës inxhinierike për vlerësimin real të nevojave të automjeteve, afati i zbatimit të këtij urdhri ka qenë data 28.02.2012.

Nga auditimi u konstatua se, fondi limit është miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 28, datë 10.02.2012, në vlerën 1,195,400 lekë, ndërsa ofertat për përlllogaritjen janë marrë pas miratimit të vlerës nga ish-Titullari, fakt që tregon se, vlera e këtij prokurimi është miratuar pa testuar më parë tregun.

Grupi i punës i caktuar nga titullari në mënyrë formale ka marrë oferta nga tre operatorë ekonomikë.

Nga Titullari i autoritetit është nxjerrë një Urdhër Prokurimi i përbashkët për Njësinë e Prokurimit, si dhe KVO, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e Prokurimit Publik”*, hartimi i dokumentave të tenderit pika ç) Komisioni i vlerësimit të ofertave, *i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor*, përbëhet nga jo më pak se 3 persona, specialistë të fushës, dhe është përgjegjës vetëm për shqyrtimin e ofertave. *“Në rastet e kontratave komplekse ose të kontratave, që kërkojnë njohuri të veçanta, teknike a juridike, autoriteti kontraktor mund të punësojë, me kontratë, specialistë të jashtëm, si anëtarë të komisionit”*.

a) Në materialin e përgatitur datë 02.04.2012, nr. prot., 281/1, pra 2 muaj me vonë, për përlllogaritjen e fondit limit, ky grup ka pasqyruar me relacione sipas automjeteve me pasqyra për çdo tip mjeti sasinë e pjesëve të këmbimi që parashikohen për furnizim vendosje, pa pasqyruar edhe sasinë gjendje në magazinë, ku llogaritja e vlerës së kontratës është parashikuar në shumën 1,198,600 lekë pa tvsh, si rezultat i testimit të tregut me 3 subjekte, ndërkohë janë administruar 2 oferta nga subjektet (“■” shpk, “■” shpk, *oferta pa datë*), të cilat pasqyrojnë çmime/njësi, për të gjitha pjesët e mjeteve që disponohen dhe do të riparohen, ndërsa përlllogaritja nuk pasqyron analizë të çmimeve të testimit të tregut dhe krahasim me çmimin e kontratës së realizuar më parë nga vetë Autoriteti Kontraktor, nuk ka dokumentacion mbështetës e justifikues mbi analizën e gjëndjes teknike të mjeteve e domosdoshmërinë e nevojave për riparim.

- Për argumentimin, përlllogaritjen e vlerës së kontratës (*fondi limit*) dhe hartimin e specifikimeve teknike në dosje grupi punës, ka llogaritur fondin limit pasqyruar nëpërmjet tabelave për çdo tip mjeti me sasi për 1 (një) njësi zë riparimi për çdo mjet dhe me vlerë pune (ndërrimi) F-V. Kjo përlllogaritje nëpërmjet tabelës si pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit në të cilën sasia e pasqyruar me 1 (një) njësi riparimi, pa dokumentuar dhe analizuar më parë gjëndjen teknike të mjeteve, kilometrat e përshkruara prej tyre, normativat e konsumit për 100/km, vitin e prodhimit, domosdoshmërinë e nevojave për riparim dhe zëvendësim të pjesëve të këmbimit, si dhe pa analizuar çmimet e kontratës e realizuar më parë nga Autoriteti Kontraktor, rezulton se, me këtë formë prokurimi (*me njësi riparimi*) nuk është prokuruar fondi publik, por është lejuar operatori ekonomik në mënyrë të drejtpërdrejt të paraqes çmime për njësi riparimi, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë

10.01.20007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, dispozitë që lidhet direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma “a” ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi Grupi punës.

b) Procedura e përzgjedhur me objekt “Riparim e mirëmbajtje automjete”, nuk është parashikuar as si “kontratë publike për shërbime”, e cila ka si objekt kryerjen e shërbimeve, ku vlera e shërbimit tejkalon atë të mallrave dhe as si “kontratë publike furnizimi”, e cila ka si objekt blerjen, ku vlera e mallrave tejkalon atë të vendosjes ose instalimit, për të cilën nga Autoriteti Kontraktor nuk pasqyron asnjë vlerësim për këtë qëllim, ndërsa evidenton hyrje fiktive në magazinë për mallra të cilat subjekti i ka vendosur në automjet me shërbimin e kryer, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime, neni 3 “Përkufizime”, pikat 5, 6. Për këtë ngarkohen me përgjegjësi Grupi punës, Njësia e prokurimit dhe Sektori Financës.

c) Kontrata nr. 293/7, datë 05.06.2012 me subjektin “ ” shpk, me vlerë 1,084,260 lekë, me afat përfundimi deri në datë 31.12.2012, është lidhur në kundërshtim me dokumentat e tenderit, konkretisht neni 12 i kontratës Garancitë në dokumentat e tenderit parashikojnë një garanci për një vit për pjesët e këmbimit dhe 6 muaj për shërbimet, ndërkohë kontrata parashikohet vetëm garanci prej 6 muajsh vetëm për shërbimet.

Në nenin 8 “Të drejtat she detyrimet e palëve”, nuk është konformë Dokumentave të Tenderit pasi, në të nuk përmenden: riparimet do të kryhen në bazë të kërkesës së hartuar nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, gjithashtu në nenin 16 të kontratës “Kontrolli i shërbimeve”, nuk parashikohet: pas çdo riparimi nga kontraktuesi, do të firmoset akti i kolaudimit nga servisi, përdoruesi i automjetit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve, në kundërshtim me dokumentat e tenderit, termat e referencës.

Gjithashtu, kontrata e nënshkruar mes palëve, nuk është në tërësinë e saj e njëjtë me Kushtet e përgjithshme të kontratës, si dhe kushtet e veçanta të kontratës, miratuar në dokumentat e tenderit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime.

Kontrata nr. 293/7, datë 05.06.2012, me subjektin “ ” shpk, me vlerë 1,084,260 lekë, me afat përfundimi deri në datë 31.12.2012, është likuiduar nëpërmjet U/Shpenzimeve (shoqëruar me faturat tatimore) në shumën totale 1,084,260 lekë, në masë 100% e vlerës së kontratës. Me likuidimet e kryera në zbatim neni 9 “Pagesa”, ku nuk evidentohet qartë se çfarë dokumentacioni duhet bashkëngjitur për likuidimin e detyrimit por, referuar nenit 16 të kontratës “Kontrolli i shërbimeve”, parashikohet: *pas çdo riparimi nga kontraktuesi do të firmoset akti i dorëzimit të përbashkët nga të dyja palët dhe mbi bazën e tij bëhet likuidimi i diferencave ...*. Nga verifikimi i praktikave financiare të likuidimit rezultoi se: servisi paraqiste një situacion punimesh për shërbimet e kryera dhe faturën tatimore të shitjes, e cila firmosej vetëm nga shoferi i automjetit, dhe po të njëjtën datë hartohej një procesverbal marrje në dorëzim nga 4 persona, përdoruesi i automjetit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve, dhe dy persona të tjere sipas urdhrorit të brendshëm të drejtorit por, që nuk firmosej nga të dy palët. Në këtë procesverbal nuk detajoheshin shërbimet, origjina e mallit dhe mbi bazën e cilës kërkesë, nga Autoriteti Kontraktor kryhej ky shërbim, praktikë që nuk ekzistonte në asnjë shërbim të kryer pra, nuk hartohej një aktdorëzimi sipas nenit 16 të kontratës, në kundërshtim me dokumentat e tenderit, termat e referencës dhe Kushtet të Kontratës.

- Nga auditimi rezultoi se, pjesët e këmbimit të ndërruara nga subjekti janë pasqyruar hyrje në magazinën e Autoritetit Kontraktor të cilësuar pjesë të reja, të shkarkuara menjëherë nga magazina me flet dalje, ndërsa përsa i përket pjesëve të zëvendësuara me të reja të cilat duhet të dorëzohen në magazinë dhe të administrohen si rikupero, nuk pasqyrohen si të tilla, në

kundërshtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi, Përgjegjësi i Administratës dhe komisioni i marrjes në dorëzim. Është për tu theksuar se, Përgjegjësi i Sektorit të Administratës, nuk kishte hapur asnjë dosje për çdo makinë ku të evidentoheshin të gjitha shërbimet që i bëheshin makinës dhe me kartela të veçanta ku shënohet çdo pjesë që i vihet dhe i hiqet asaj. Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2. Për vitin 2013, është ndjekur e njëjta procedurë prokurimi, dhe konstatohen të njëjtat shkelje ligjore të konstatuara dhe në vitin 2012.

- Në tenderin me objekt **“Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve të ISHP-së”**.

Lidhur me përllogaritjen e fondit limit duhet të theksojmë se, në materialin e përgatitur datë 17.06.2013, nr. prot., 180/1, për përllogaritjen e fondit limit, ky grup ka pasqyruar me relacione sipas automjetve me pasqyra për çdo tip mjeti sasinë e pjesëve të këmbimi që parashikohen për furnizim vendosje, ku llogaritja e vlerës së kontratës është parashikuar në shumën 900,000 lekë pa tvsh, referuar kontratës së mëparshme pa kryer asnjë testim tregu. Përllogaritja e vlerës së kontratës (*fondi limit*) dhe hartimi i specifikimeve teknike në dosje grupi punës e ka pasqyruar nëpërmjet tabelave për çdo tip mjeti) me sasi për 1 (një) njësi zë riparimi për çdo mjet dhe me vlerë pune (ndërrimi) F-V. Kjo përllogaritje nëpërmjet tabelës si pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit në të cilën sasia e pasqyruar me 1 (një) njësi riparimi, pa dokumentuar dhe analizuar më parë gjendjen teknike të mjeteve, kilometrat e përshkruara prej tyre, normativat e konsumit për 100/km, vitin e prodhimit, domosdoshmërinë e nevojave për riparim dhe zëvendësim të pjesëve të këmbimit, si dhe pa analizuar çmimet e kontratës e realizuar më parë nga autoriteti kontraktor, rezulton se, me këtë formë prokurimi (*me njësi riparimi*) nuk është prokuruar fondi publik por, është lejuar operatori ekonomik në mënyrë të drejtpërdrejtë të paraqesi çmime për njësi riparimi, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.20007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, dispozitë që lidhet direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma “a” ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime. **Theksojmë se, zërat e parashikura për furnizim vendosje për çdo makinë, janë të njëjta me ato të vitit 2012, ku e njëjta makinë çdo vit kryen të njëjtat ndërrim pjesësh, si rrip motori, koka zbarash, grup timoni, sinjale të pasme, etj. Çuditërisht asnjë makinë e ISHP-së, nuk kryen shërbime të natyrave të zakonshme që kryen një makinë, si filtra, vaj apo dhe difekte të ndryshme që ndodhin.**

Kontrata nr. 548/8, datë 06.08.2013, sërisht me subjektin “**■**” shpk, i paraqitur i vetmi në prokurim, me vlerë 1,000,440 lekë, me afat përfundimi deri në datën 31.12.2013, është likuiduar nëpërmjet Urdhër Shpenzimeve (*shoqëruar me faturat tatimore*) në shumën totale 1,000,440 lekë, në masën 100% të vlerës së kontratës. Me likuidimet e kryera, në zbatim nenit 9 “Pagesa”, ku nuk evidentohet qartë se çfarë dokumentacioni duhet bashkëngjitur për likuidimin e detyrimit por, referuar nenin 16 të kontratës “Kontrolli i shërbimeve”, parashikohet: pas çdo riparimi nga kontraktuesi do të firmoset akti i dorëzimit të përbashkët nga të dyja palët dhe mbi bazën e tij bëhet likuidimi i diferencave ... Nga verifikimi i praktikave financiare të likuidimit rezultoi se: servisi paraqiste një situacion punimesh për shërbimet e kryera dhe faturën tatimore të shitjes e cila firmosej vetëm nga shoferi i automjetit, dhe po të njëjtën datë hartohet një procesverbal marrje në dorëzim nga 4 persona, përdoruesi i automjetit dhe përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe dy persona të tjerë sipas

urdhrit të brendshëm të drejtorit por, që nuk firmosej nga të dy palët. Në këtë procesverbal nuk detajoheshin shërbimet, origjina e mallit dhe mbi bazën e cilës kërkesë nga Autoriteti Kontraktor kryhej ky shërbim, praktikë që nuk ekzistonte në asnjë shërbim të kryer. Pra nuk hartohej një akt dorëzimi sipas nenit 16 të kontratës, në kundërshtim me dokumentat e tenderit, termat e referencës dhe Kushteve të kontratës.

Nga auditimi rezulton se, pjesët e këmbimit të ndërruara nga subjekti janë pasqyruar hyrje në magazinën e autoritetit kontraktor të cilësuar pjesë të reja, të shkarkuara menjëherë nga magazina me fletë dalje ndërsa, përta i përketë pjesëve të zëvendësuar me të reja të cilat duhet të dorëzohen në magazinë dhe të administrohen si rikupero nuk pasqyrohen si të tilla, në kundërshtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi, Përgjegjësi i Administratës dhe komisioni i marrjes në dorëzim.

Marrja në dorëzim e automjeteve, pas riparimit nga komisioni i ngritur me urdhër të Titullarit të institucionit, është bërë formal, duke firmosur situacionet dhe procesverbalet e punimeve, pa verifikuar numrin ose kodin e skemës origjinale të montimit, numri ose kodin original i referencës për pjesën e këmbimit të kërkuar të nevojshme për montim gjatë riparimit të mjetit, si dhe numrin ose pozicionin e pjesës së këmbimit në skemën e montimit, si dhe origjinën e pjesëve të këmbimit të përdorura, sipas furnizimeve të bëra nga firma prodhuese ose, tregtuese të pjesëve të këmbimit, kërkesa të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në situacionet e firmosura nga komisioni janë të shënuara emri i pjesës së këmbimit, sasia, çmimi dhe vlera pa shënuar asnjë referencë përta shprehet më sipër.

Gjithashtu mungojnë urdhrat e punës, ku të jetë shënuar identiteti, numri i fletdaljes së magazinës për pjesët e këmbimit të tërhequra për riparim, dhe origjina e blerjes së pjesëve të këmbimit, etj. Pra, nuk del qartë nëse realisht janë kryer të gjitha riparimet sipas zërave të përcaktuara në aneksin e kontratës për çdo automjet, apo ka abuzime në punimet e kryera.

Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Më datë 15.04.2014, në prani të N/Drejtorit Ekonomik znj. ■, Përgjegjësit të Administratës z. ■ dhe grupit të auditit u bë verifikimi në vend i makinave të ISHP-së, gjithsej 11 makina.

Nga grupi i auditimit u kërkuar plani i shpërndarjes për datën 15.04.2014, i cili nuk disponohej nga Përgjegjësi i Administratës, megjithatë nga ana e tij u bë deklarata verbale mbi vendodhjen e makinave, të cilat një pjesë rezultonin me shërbim në qytete të ndryshme sipas projekteve.

Në oborrin e ISHP-së, rezultoi se, ishin prezent automjeti Toyota TR 6425 A në përdorim nga Përgjegjësi i Administratës, makinë e cila nuk përdorej prej tij pasi, përdorte makinë private, megjithëse për këtë automjet kryhen shërbime riparimi çdo vit dhe tërhiqet naftë sipas konsumit të matur për këtë automjet. Automjeti TOYOTA TR 7561A në përdorim nga z. ■ vendodhja në ISHP, ndërkohë që raportej në Berat, parkuar në ISHP. Automjeti TOYOTA TR2436B në përdorim nga z. ■ vendodhja në ISHP. Automjeti Benz Furgon TR 7463 A në përdorim nga z. ■ rezultoi në ISHP, Automjeti Toyota TR 6987 A në përdorim nga z. ■ rezultoi në ISHP, ndërkohë që raportohet në Lushnjë. Automjetet TOYOTA 7495G në përdorim nga z. ■ raportuar me shërbim në Lezhë, nga verifikimi dhe me drejtuesen e projektit, rezulton shoferi me shërbim por, me makinën personale pasi, shpenzon më pak. Po e njëjta situatë dhe për automjetin Toyota TR7460A në përdorim nga z. ■ dhe automjetin Toyota TR 7853G në përdorim nga z. ■, e cila raportohet me shërbim në Vlorë. ***Automjetet pronë e ISHP-së, me normativa nga 12-18 litra/km, ku kryesisht lëvizjet më të shumta kryhen nga makinat me normativat më të larta të harxhimit, nuk përdoren nga shoferat me justifikimin e normativave të larta të harxhimit dhe zëvendësohen nga makinat e tyre private, por në fakt shpenzimi i karburantit bëhet bazuar në normativat e automjeteve të***

ISHP-së, veprim ky i miratuar dhe nga Përgjegjësi i Administratës i cili po vetë ka në përdorim mjet privat ndërkohë që tërheqjet e naftës për konsum bëhen për automjetet e ISHP-së. Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për sa më lartë ngarkohet me përgjegjësi Përgjegjësi i Administratës z. ■ .

II. Për administrimin e karburantit.

1. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, ku citohet: *“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve”,* në Institutin e Shëndetit Publik për vitet 2012-2013, janë harxhuar për lëvizje të brendshme **8,810 litra karburant ne vlerën 1,585,800 lekë**, që nuk justifikohet me dokumentacion të rregullt dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe mban përgjegjësi z. ■, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Administratës.

2. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të projekteve të paraqitura nga Sektori i Financësi, për shpenzimet e kryera për periudhën objekt auditimi (01.01.2012 deri me 31.12.2013), në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, u konstatuan raste ku, nga kryqëzimi i të dhënave midis lëvizjeve të shoferave në dispozicion të projekteve në të cilat ata rezultojnë me shërbim dhe kanë përfituar dieta, si dhe fletë udhëtimeve të plotësuara për lëvizjet e brendshme në dispozicion të administratës së ISHP-së, për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar rezultoi se, shoferat e ISHP-së, **janë në dy vendodhje në të njëjtën ditë dhe përshkrojnë km të ndryshme në të njëjtën kohë që fletë udhëtimeve e tyre pasqyrojnë lëvizje në Tiranë dhe kanë përfituar padrejtësisht shumën 319,000 lekë.**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT